

# Korrupsioni në Shqipëri

Perceptime dhe Përvoja

**SONDAZHI 2005**

Përmbledhje e Rezultateve



Qershor 2006

## Pasqyra e lëndës

Faqe

<b>1. Hyrje.....</b>	<b>3</b>
<b>2. Metodologjia e sondazhit dhe toleranca e gabimit.....</b>	<b>4</b>
<b>3. Paraqitja e rezultateve.....</b>	<b>5</b>
<b>4. Rezultatet.....</b>	<b>6</b>
4.1 Perceptimi i korrupsionit.....	6
4.2 Viktimizimi nga korrupsioni.....	7
4.3 Kontributi në luftën kundër korrupsionit.....	8
4.4 Transparenca.....	9
4.5 Besimi në institucione dhe mbështetja për sistemin politik.....	10
4.6 Sjellja ndaj korrupsionit.....	11
4.7 Përfshirja e shoqërisë civile në luftën kundër korrupsionit.....	13
4.8 Krimi dhe drejtësia.....	14
4.9 Korrupsioni në sektorin publik.....	16

## Përmbledhje e Rezultateve

## 1. Hyrje<sup>1</sup>

Ky raport paraqet rezultatet nga pesë sondazhe të kryera në Shqipëri me katër kampione të ndryshme në dy periudha. Sondazhi i parë i është bërë publikut të gjerë në 10 qytete të Shqipërisë në periudhën Dhjetor 2003 - Janar 2004. Katër sondazhet e tjera u kryen dy vjet më pas, në Dhjetor 2005 - Janar 2006, duke përdorur kampionin e 10-qyteteve (të ngjashëm me kampionin e vitit 2004), një kampion kombëtar, një kampion me nëpunës publikë dhe një kampion me gjyqtarë.

Objektivi kryesor i të dy sondazheve (2004, 2005) është të masë perceptimet dhe sjelljet e shqiptarëve në lidhje me korrupsionin. Seria e sondazheve të vitit 2005 na jep mundësinë që të shikojmë edhe ndryshimin që ka ndodhur në opinionin publik gjatë periudhës 2004-2005 si dhe dallimet që mund të ekzistojnë ndërmjet kampioneve urbanë, kombëtarë, të nëpunësve publikë dhe gjyqtarëve.

Krahasimet ndërmjet katër kampioneve të ndryshme janë të kufizuara vetëm për atë grup

pyetjesh që janë të njëjta për të gjithë. Ky grup përfshin çështje të tilla si sjellja ndaj korrupsionit, viktimizimi nga korrupsioni, perceptime në lidhje me disa institucione të përfshira në luftën kundër korrupsionit, transparencë dhe besimi në institucionet publike dhe mbështetja për sistemin politik shqiptar. Përveç këtij grupi pyetjesh, sondazhi përmban edhe pyetje të tjera që janë specifike për çdo kampion (kampioni urban, kombëtar, i nëpunësve publikë dhe ai i gjyqtarëve) dhe që trajtojnë çështje të tilla si viktimizimi nga krimi, drejtësia, dhe korrupsioni në sektorin publik.

Ky sondazh u krye gjashtë muaj pas zgjedhjeve të përgjithshme në Shqipëri (Korrik 2005) dhe katër muaj pas ndryshimit të qeverisë që rezultoi nga këto zgjedhje. Opinione dhe qëndrimet e publikut që rezultojnë nga ky sondazh mund të jenë ndikuar nga fakti që “korrupsioni” ishte tema kryesore e fushatës elektorale dhe që qeveria që rezultoi nga këto zgjedhje erdhi në pushtet me premtimin që do të luftonte korrupsionin.

1



Ky botim është bërë për shqyrtim nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Kombëtar. Ai u përgatit nga Instituti për Kërkime dhe Alternativa Zhvillimi (IDRA) dhe nga Casals & Associates, Inc. nëpërmjet Projektit të Shtetit Ligjor. Pikëpamjet e autorëve të shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar ose të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

## 2. Metodologjia e sondazhit dhe toleranca e gabimit

Ky sondazh është kryer në bazë të standarteve më të larta ndërkombëtare për të arritur rezultatet më të besueshme të mundshme. Më poshtë jepet një sqarim i metodologjisë së përdorur:

### Madhësia e kampioneve:

a)	Kampioni Urban (2004 dhe 2005) <sup>2</sup>	– N=1200 (Vjeç 18+)
b)	Kampioni Kombëtar ( 2005)	– N=1200 (Vjeç 18+)
c)	Kampioni i Nëpunësve publikë (2005)	– N=577
d)	Kampioni i Gjyqtarëve (2005)	– N=155

### Kampionimi

- Urban dhe Kombëtar - Rastësor me disa nivele
- Nëpunësit publikë - Kampione përfaqësuese të katër grupeve të ndryshme të nëpunësve publikë nga Administrata Qendrore, Autoritetet Lokale, Sistemi Shëndetësor, Sistemi Arsimor)
- Gjyqtarët – Universi i gjyqtarëve në Shqipëri (367 gjyqtarë)

*Metoda e sondazhit* – ballë për ballë

### Toleranca e gabimit

Si kampioni urban, ashtu edhe ai kombëtar ishin të përbërë nga 1200 persona, gjë që sjell një tolerancë gabimi prej  $\pm 2.8\%$ , me një interval besueshmërie 95%. Teknikisht një gjë e tillë do të thotë se, nëse ne marrim 100 kampione me të njëjtën madhësi, atëherë në 95 prej tyre rezultatet do të kenë një gabueshmëri vetëm  $\pm 2.8\%$  nga njëra-tjetra. Toleranca e gabimit për sondazhin e nëpunësve publikë është  $\pm 4\%$ , ndërsa për sondazhin e gjyqtarëve  $\pm 6\%$ .

2. Sondazhi është kryer në 10 qytete kryesore të Shqipërisë: Tiranë, Durrës, Berat, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Korçë, Lushnje, Shkodër dhe Vlorë.

## Përmbledhje e Rezultateve

### 3. Paraqitja e rezultateve


Shumica e rezultateve në këtë raport janë paraqitur në një shkallë nga 0-100. Shkallët e ndryshme në pyetësor janë konvertuar në shkallën 0-100 për një kuptueshmëri dhe paraqitje sa më të mirë.

Më poshtë tregohet një shembull i një konvertimi të tillë nga një pyetje në pyetësor:

*Tani do të përmend emrat e disa institucioneve të ndryshme publike dhe private. Unë jam i interesuar të di se sa të korruptuar apo të ndershëm janë përfaqësuesit e këtyre institucioneve. Ju lutem, i vlerësoni ata me numrat nga 1 deri në 10, ku 1 do të thotë Shumë i Ndershëm dhe 10 Shumë i Korruptuar.*

INSTITUCIONET	Nivelet e Korrupsionit										
	Shumë i ndershëm						Shumë i korruptuar				ND
Tatimorët	(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)	(8)	(9)	(10)	(88)

Konvertimi është bërë duke zbritur 1 nga secili numër i shkallës 1-10 kështu që shkalla kthehet në 0-9. Më pas, kjo shkallë pjesëtohet me 9 dhe shumëzohet me 100 duke u kthyer në një shkallë në 0-100. Sipas kësaj shkalle, 0=shumë i ndershëm dhe 100=shumë i korruptuar. Një grafik ilustrues është paraqitur në të djathtë.



Nëse “Tatimorët” në këtë grafik rezultojnë “83.1”, kjo **NUK** do të thotë se 83,1% e të intervistuarve mendojnë se nëpunësit tatimorë janë të korruptuar. Do të thotë se të intervistuarit, dhe, për rrjedhojë, të gjithë shqiptarët, mendojnë se nëpunësit tatimorë janë shumë të korruptuar – numri 83,1 përfaqëson perceptimin se sa i korruptuar është një institucion, në një shkallë nga 0-100.

Raporti më poshtë paraqet vetëm një përmbledhje të rezultateve, ndërkohë që dokumenti i plotë i punës mund të shkarkohet nga adresa e IDRA-s në internet: [www.idra-al.org](http://www.idra-al.org)

### Përmbledhje e Rezultateve

## 4. Rezultatet

### 4.1. Perceptimi i korrupsionit

Ky grup pyetjesh synon të pasqyrojë perceptimin e qytetarëve për integritetin në institucione dhe grupe të ndryshme.

- Në të tre kampionet e 2005 (kombëtar, urban dhe nëpunësit publikë):
  - Presidenti i Republikës, Drejtuesit Fetarë dhe Ushtarakët vlerësohen si më ndershmit ndërmjet 17 institucioneve dhe grupeve të përmendura në sondazh.
  - Doganierët, Tatimorët, Mjekët, Gjyqtarët dhe Deputetët shihen si më të korruptuarit.
- Në kampionin urban, nga 17 institucionet dhe grupet e vlerësuara në lidhje me sa të korruptuara ato janë, nga 2004 në 2005, është **përmirësuar** perceptimi për grupet e mëposhtme: Deputetët, Ministrat, Gjyqtarët, Drejtuesit e OJF-ve, Prokurorët dhe Doganieret. Megjithatë, perceptimi i përgjithshëm për këto grupe mbetet përsëri negativ. Me përjashtim të drejtuesve të OJF-ve (37,6), të gjithë kanë kaluar numrin 60 në shkallën e perceptimit të korrupsionit. [Fig. 2]
- Perceptimet e korrupsionit për Gjyqtarët dhe Drejtuesit e OJF-ve në 2005 janë **më pak të favorshme** ndërmjet nëpunësve publikë krahasuar me publikun e gjërë.

Fig.1 Ndershmëria vs Korrupsionit në grupet e mëposhtme (2005 Kombëtar)





Fig.2 Ndershmëria vs Korrupsionit në grupet e mëposhtme (Krahasim 2004-2005)



## 4.2. Viktimizimi nga korrupsioni

Shumica e pyetjeve të sondazhit janë të bazuara në **perceptim**, por një numër pyetjesh kanë si qëllim që të evidentojnë edhe korrupsionin në bazë të **përvojës**. Për shembull, të intervistuarit janë pyetur nëse ata kanë paguar ryshfete për të siguruar shërbime të ndryshme publike ose gjatë marrëdhënieve me nëpunësit publikë, gjatë vitit të kaluar. Dhjetë pyetje që lidhen me përvojën personale<sup>3</sup> janë përdorur për të ndërtuar një indeks i cili mat numrin e mënyrave me anë të të cilave është viktimizuar çdo i intervistuar.

- Përqindja e të intervistuarve që kanë thënë se iu është dashur të paguajnë para “nën dorë” për mjekë/infermierë është shumë më e madhe se në skenarët e tjerë të ryshfeteve – një pasqyrim i qartë i nivelit të lartë të korrupsionit në sektorin e shëndetësisë. [Fig. 3]
- Megjithatë, përqindja e atyre që kanë paguar ryshfet për mjekët/infermierët në kampionin urban ka rënë me pothuajse 4% nga 2004 në 2005. Një tjetër përmirësim duket se ka në “administratën publike” ku përqindja e atyre që kanë pranuar se u është kërkuar nga nëpunësit publikë të paguajnë ryshfet ka rënë nga 20,4% në 14,1%. [Fig. 3]
- Nga maksimumi 10 mënyra sesi një person mund të viktimizohet nga korrupsioni, numri mesatar i mënyrave të viktimizimit është më pak se 2. Mesatarisht një banor i qyteteve kryesore është viktimizuar me 1,8 mënyra në 2005, një ulje prej 0,2 pikësh nga 2004. Mesatarja e viktimizimit për kampionin e nëpunësve publikë është në mënyrë të konsiderueshme më e ulët se ajo e kampionit kombëtar. [Fig. 4]
- Kur krahasojmë grupe qytetesh, del se ka një rënie të konsiderueshme të mënyrave, sipas të cilave njerëzit bienin për e korrupsionit në Tiranë. Një rënie edhe më të madhe të këtij indeksi ka në qytetet më të vogla: Berat, Fier, Gjirokastrë, Korçë dhe Lushnje.

Fig.3 A kanë ndodhur veprimet e mëposhtme gjatë vitit të kaluar? (Krahasim 2004-2005). Ata që janë përgjigjur “Po”.





Fig.4 Viktimizimi nga korrupsioni



3. Të intervistuarit u pyetën nëse u ishte kërkuar nga nëpunës të ndryshëm publikë të paguanin ryshfet, nëse ata kishin paguar ryshfet, ose nëse ata kishin parë dikë të paguante ryshfet. Ishin gjithsej 10 pyetje të tilla, të cilat përcaktuan 10 mënyra të mundshme se si njerëzit mund të bienin për e korrupsionit.

### 4.3. Kontributi ne luften kunder korrupsionit

Me një përjashtim, të gjitha institucionet janë vlerësuar me më pak se 50 pikë (mesi i shkallës) në shkallën 0-100, duke nënkuptuar se performanca e tyre në luftën kundër korrupsionit është vlerësuar si jo e kënaqshme. Një përjashtim i dallueshëm është Media, e cila ka marrë mbi 50 pikë në të gjitha kampionet. Institucionet e vlerësuara më keq janë Gjykatat dhe Prokuroria e Përgjithshme. [Fig. 5]

Vlerësimi i publikut për kontributin në luftën kundër korrupsionit është përmirësuar në kampionin urban nga 2004 në 2005 për këto institucione: Qeveria, Kontrolli i Lartë i Shtetit, Njësia e Monitorimit Anti-Korrupsion (NJMAK)<sup>4</sup>. [Fig. 6]

Vlerësimi i nëpunësve publikë për kontributin e Qeverisë dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit është më i lartë në krahasim me vlerësimin e publikut të gjerë. Ndërsa Media është vlerësuar më pak nga nëpunësit publikë në krahasim me publikun e gjerë.

Fig.5 Në ç'masë institucionet e mëposhtme ndihmojnë në luftën kundër korrupsionit (2005 Kombëtar)<sup>5</sup>





Fig.6 Në ç'masë institucionet e mëposhtme ndihmojnë luftën kundër korrupsionit (Krahasim 2004-2005)



4. Tashmë kjo njësi nuk ekziston më në këtë lloj forme.

5. Në Fig. 5 "ILKDP" i referohet Inspektoriatit të Lartë të Kontrollit dhe Deklarimit të Pasurive.



#### 4.4. Transparenca

▪ Transparenca mbetet një sfidë për institucionet publike. Me përjashtim të Forcave të Armatosura, të gjitha institucionet e tjera kanë marrë më pak se 50 pikë (mesi i shkallës së transparencës). Më pak transparente janë vlerësuar Gjykatat. [Fig. 7]

▪ Megjithatë ka një përmirësim relativisht të madh në perceptimin e transparencës së të gjitha institucioneve në kampionin urban nga viti 2004 në vitin 2005. Ngritja më e dallueshme është ajo e Qeverisë e cila, nga 21,3 pikë në 2004, u vlerësua me 42,4 pikë në 2005. [Fig. 8]

▪ Ky përmirësim mund të shpjegohet me ndikimin e zgjedhjeve të përgjithshme të Korrikut 2005 dhe ndërrimin e qeverisë që rezultoi nga këto zgjedhje, të cilat mund të kenë prodhuar efektin e "muajt të mjaltit" ndërmjet qytetarëve dhe qeverisë.

▪ Vlerësimi i transparencës gjithashtu është përmirësuar në institucionet e mëposhtme nga 2004 në 2005: Parlamenti, Kontrolli i Lartë i Shtetit, Prokuroria e Përgjithshme dhe Gjykatat. [Fig. 8]

▪ Vlerësimi i transparencës në institucionet e mëposhtme është më i lartë në kampionin e nëpunësve publikë krahasuar me publikun e gjerë: Pushteti Vendor, Parlamenti, Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe Qeveria Qendrore.

Fig.7 Sa transparente janë institucionet e mëposhtme? (2005 Kombëtar)





Fig.8 Sa transparente janë institucionet e mëposhtme? (Krahasim 2004-2005)



#### 4.5. Besimi në institucione dhe mbështetja për sistemit politik<sup>6</sup>

Pyetësi gjithashtu kishte si qëllim të maste besimin publik në institucionet shoqërore dhe politike si dhe mbështetjen e përgjithshme për sistemin politik.

- Forcat e Armatosura kanë nivelin më të lartë të besimit në të katër kampionet; Partitë Politike dhe Sindikatat kanë besimin më të ulët. Në kampionet e publikut të gjerë, me përjashtim të Forcave të Armatosura dhe Drejtuesve Fetarë, të gjitha institucionet kanë marrë më pak pikë se mesi i shkallës (më pak se 50 pikë) duke treguar se besimi publik në këto institucione është ende i ulët. [Fig. 9]
- Besimi në institucionet publike është i ulët edhe ndërmjet atyre që shërbejnë në to (nëpunësit publikë). Në përgjithësi, besimi i nëpunësve publikë në institucione është më i lartë se i publikut të gjerë, por, përsëri, në terma absolutë mbetet i ulët.
- Mbështetja për sistemin politik u rrit me 8.7 pikë në vitin 2005 në kampionin urban, por përsëri mbetet poshtë mesit të shkallës së vlerësimit. Mbështetja në shkallë kombëtare është pak më e lartë se në qytete, ndërsa ndërmjet nëpunësve publikë është më e lartë se publiku i gjerë. [Fig. 10]
- Rritja e përgjithshme e mbështetjes për sistemin politik në zonat urbane nga viti 2004 në vitin 2005 mund të shpjegohet kryesisht me rritjen e madhe të kësaj mbështetjeje në qytetin e Tiranës. Qytetet e vogla (Berat, Fier, Gjirokastrë, Korçë, Lushnje) patën një rritje më të vogël në mbështetjen për sistemin politik.
- Nga sondazhi del një korrelacion negativ midis numrit të mënyrave sipas të cilave të intervistuarit bien pre e korrupsionit dhe mbështetjes për sistemin politik; mbështetja bie kur viktimizimi rritet. I njëjti korrelacion qëndron edhe pas kontrollit për gjini, moshë e pasuri. Kjo tregon se korrupsioni minon mbështetjen për sistemin politik.

Fig.9 Besimi në institucione (Kombëtar 2005)





Fig.10 Mbështetja për sistemin politik



6. Mbështetja për sistemin politik është një tregues i përbërë që mat se në çfarë nivel qytetarët mendojnë se duhet të qeverisen nga sistemi politik ekzistues. Treguesi është ndërtuar nga përgjigjet e 5 pyetjeve.

#### 4.6. Sjellja ndaj korrupsionit

▪ “Transaksionet e korrupsionit”, p.sh. ryshfetet, kërkojnë dy palë që të realizohen – atë që jep dhe atë që merr. Sondazhi trajton disa skenarë për të parë sjelljen e publikut ndaj përmasave të ndryshme të korrupsionit. Një veçori e veçantë del nga të gjitha skenarët e diskutuara: personi që merr ryshfetin gjykohet gjithnjë më rëndë se ai që e jep ryshfetin. [Fig. 11]


▪ Pothuajse 68% e të intervistuarve mendojnë se “një student që i jep mësuesit një dhuratë me shpresën për të marrë një notë më të mirë” ose **nuk është i korruptuar** ose **është i justifikuar**. [Fig. 11]

▪ Të intervistuarit kanë një “mirëkuptim” më të madh për rastin e “nënës që paguan ryshfet për të marrë një certifikatë lindjeje për një nga fëmijët e saj.” Pothuajse 77% e të intervistuarve mendojnë se ajo ose **nuk është e korruptuar** ose **është e justifikuar**. [Fig. 11]


▪ Ajo ç’ka duket interesante, kampioni që u përgjigj më shumë në favor të saj nga të katër kampionet, pra që e justifikon nënën që paguan ryshfet për të marrë një certifikatë lindjeje, është kampioni i nëpunësve publikë (64%).

Fig.11 Sjellje ndaj korrupsionit (Kombëtar 2005)

##### Marrësit




##### Dhënësit



Përgjigjet ndaj skenarit të mëposhtëm ilustrojnë një qëndrim të përhapur:

- Të pyetur për perceptimet në lidhje me një shitës lulesh i cili rrit çmimet e luleve në ditë festash, një përqindje e madhe e të intervistuarve në të tre kampionet e konsiderojnë këtë shitës lulesh si të korruptuar dhe mendojnë se ai duhet ndëshkuar. [Fig. 12]
- Ky rezultat është interesant, sepse këto veprime të shitësit nuk kanë lidhje me korrupsionin. Vendimi i shitësit për të rritur çmimin e mallrave të caktuara (si lulet p.sh.) në përgjigje të rritjes së kërkesës së konsumatorëve është parim kryesor i ekonomisë së tregut.

Fig.12 Shitësi i luleve që rrit çmimin e luleve në ditët e festave



#### 4.7. Përfshirja e shoqërisë civile në luftën kundër korrupsionit

- Ndërgjegjësimi i publikut në lidhje me nismat antikorrupsion të shoqërisë civile ka një rënie të ndjeshme nga 2004 në 2005 në kampionin urban. Në kampionin kombëtar ky ndërgjegjësim është pak më i ulët në 2005 se në atë urban. Ndërsa në kampionin e nëpunësve publikë ndërgjegjësimi është më i lartë në lidhje me nismat e shoqërisë civile sesa në kampionin kombëtar. [Fig. 13]
- Ka një nivel shumë të lartë mbështetjeje në të katër kampionet për sa i përket bashkëpunimit të shoqërisë civile me qeverinë në luftën kundër korrupsionit. Nga 94% në kampionin urban të 2004 kjo mbështetje u rrit në 98% në 2005.
- Përqindja e të intervistuarve që janë në dijeni të punës së Koalicionit Shqiptar Kundër Korrupsionit (ACAC) u rrit në kampionin urban me afërsisht 5% nga 2004 në 2005 duke shkuar pothuajse në 18%. [Fig. 14]
- Në kontrast me këto shifra të ulëta nga kampioni urban, pothuajse një në katër nëpunës publikë është në dijeni të punës së ACAC. [Fig. 14]
- Qytetarët përdorin televizionin si burim kryesor të informacionit në lidhje me rastet e korrupsionit. Në të katër kampionet, më shumë se 70% e të intervistuarve përmendën këtë si burim.

Fig.13 Njohja e nismave antikorrupsion të shoqërisë civile





Fig.14 Njohja e punës së ACAC-it



#### 4.8. Krimi dhe drejtësia

- Viktimizimi nga krimi i raportuar nga të intervistuarit pothuajse është përgjysmuar nga 2004 në 2005 në kampionin urban. [Fig. 15]
- Në të tre kampionët më pak se gjysma e viktimeve e raportojnë krimin. Arsyeja kryesore më e shpeshtë e përmendur nga ata që nuk raportojnë është se “nuk ia vlen” – duke reflektuar mes të tjerash mungesë besimi në sistemin e drejtësisë.
- Në kampionin urban të intervistuarit raportuan se janë trajtuar më keq nga policia në 2005 se në 2004. Vlerësimi mesatar ka kaluar nën pikën e mesit të shkallës nga 0-100 në 2005, ndërkohë që në 2004 ai ka qenë mbi pikën e mesit. Nuk ka ndonjë dallim në të tre kampionet për sa i përket trajtimit në gjykata. Vlerësimi mesatar është poshtë mesit të shkallës 0-100 duke nënkuptuar një performancë të përgjithshme të dobët të gjykatave.
- Vlerësimi i shërbimit në bashki/komuna është pak më i lartë në kampionin kombëtar sesa në atë urban për vitin 2005.
- Njerëzit në qytetet kryesore ndihen më të sigurtë në lagjet e tyre krahasuar me 2004. Situata duket edhe më e mirë në nivel kombëtar.
- Besimi tek sistemi gjyqësor për të dhënë drejtësi për viktimat e krimit, nga një nivel shumë i ulët në 2004, ra edhe më shumë në 2005 në kampionin urban, megjithëse në nivel kombëtar besimi është pak më i lartë. Një mesatare prej rreth 35 pikësh në të tre kampionet tregon se shqiptarët kanë besim të ulët në sistemin gjyqësor. [Fig. 16]

Fig.16 Viktimizimi nga krimi<sup>7</sup>





Fig.17 Besimi se sistemi i drejtësisë ndëshkon kriminelët



7. Përqindja e të intervistuarve që kanë thënë se kanë qenë viktime të krimit.

## Nga Sondazhi i Gjyqtarëve<sup>8</sup>

- Pak më shumë se gjysma e gjyqtarëve të intervistuar mendojnë se korrupsioni në sistemin gjyqësor shqiptar është një problem serioz dhe se avokatët i takojnë ata jashtë gjykatës për të ndikuar vendimet e tyre. [Fig. 17]
- Gjyqtarët janë të ndërgjegjshëm se, si ata, ashtu edhe avokatët, nuk shihen në dritë pozitive nga publiku; të dyja kategoritë marrin vlerësime mesatare shumë poshtë mesit të shkallës nga 0-100. [Fig. 18]
- Gjyqtarët e pëlqejnë cilësinë e trajnimit në Shkollën e Magjistraturës, duke i dhënë asaj rreth 71 pikë, një sasi pikësh kjo dukshëm mbi pikën e mesit në grafik. [Fig. 18]
- Nga shtatë faktorë të rëndësishëm për punën e tyre, gjyqtarët janë më shumë të kënaqur me cilësinë e personelit me të cilin ata punojnë dhe më pak të kënaqur me pagesën e punonjësve të tyre.
- Një numër i madh gjyqtarësh përmendën trajnimin si një faktor që do t'i ndihmonte ata për të përmirësuar performancën e tyre. Faktori tjetër më i përmendur është rritja e pagave.
- Shumica e gjyqtarëve mendojnë se lloji i trajnimit më të rëndësishëm që duhet të marrin është edukimi ligjor i vazhdueshëm për t'i mbajtur të informuar me ligjet e reja që dalin.

Fig 18. Vlerësimi i "dobësisë" së gjyqtarëve dhe gjykatave ndaj korrupsionit





Fig.19 Vlerësimi i perceptimit publik mbi avokatët, gjyqtarët dhe trajnimi në shkollën e magjistraturës



8. U intervistuan 155 gjyqtarë në të gjithë Shqipërinë nga 367 gjyqtarë. Toleranca e gabimit për këtë kampion është  $\pm 6\%$ .

#### 4.9. Korrupsioni në sektorin publik<sup>9</sup>

Pyetësi i nëpunësve publikë kishte gjithashtu edhe disa pyetje specifike vetëm për këtë kampion. Më poshtë janë disa nga rezultatet e këtyre pyetjeve:

- Sipas nëpunësve publikë pasojat e ndikimit politik në marrjen në punë dhe ngritjen në detyrë ndihen më shumë në sistemin arsimor dhe më pak në administratën vendore.
- Pothuajse 65% e atyre që janë përgjigjur nga kampioni i nëpunësve publike (një e treta e kampionit) thonë se për të marrë një kontratë prokurimi duhet të paguash ryshfet. 40% e tyre thanë se ky ryshfet varion nga 1-10%, ndërsa 25% thanë se ky ryshfet është më i madh se 10% e vlerës së kontratës. [Fig. 19]
- Sipas nëpunësve publikë, ryshfeti përdoret më shumë për të ndikuar në vendimet që kanë të bëjnë me përftimin e shërbimeve publike dhe kontratave sesa ato që kanë të bëjnë me ndryshimet e ligjeve dhe akteve nënligjore.
- Pagesa e ryshfeteve për të përftuar shërbime publike duket se është më e përhapur në sistemin mjekësor dhe më pak e përhapur në administratën vendore.
- Pagesa e ryshfeteve ndaj nëpunësve publikë duket se është më e shpeshtë në sektorin publik dhe ndërmjet biznesmenëve vendas. Ndërkohë që perceptimi për ryshfete nga investitorët e huaj dhe organizata ndërkombëtare është shumë më i ulët. [Fig. 20]

Fig.20 Ryshfeti në prokurime si përqindje e vlerës së kontratës





Fig.21 Perceptimi i përhapjes së ryshfeteve



9. U intervistuan 577 nëpunës publikë në të gjithë Shqipërinë. Toleranca e gabimit për këtë kampion është  $\pm 4\%$ .